



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 198 /2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur ndaj Bekim Troni, për shkak të ndikimit në votues, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kaçanik.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 17 Qershor 2012, rreth orës 16:30, në fshatin Kovaçec, në shkollën “ Idriz Seferi”, në QV 0719D, personi me emrin Bekim Troni, Drejtor i Urbanizmit Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit, ka qëndruar në këtë qendër me bexh dhe ka bërë presion tek votuesit, ku sipas parashtruesit të ankesës, rastin e ka raportuar vëzhguesi i subjektit politik LVV. Gjithashtu parashtruesi në ankesë thekson se vëzhguesi i LVV Zgjim Hyseni ka shkuar në këtë QV që të zëvendësoj vëzhguesin Vedat Mexhuani, për shkak të lodhjes, mirëpo nuk është lejuar, dhe është larguar dhunshëm nga QV, nga Bekim Troni dhe pesë persona tjerë. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore 13/2009, neni 7 paragrafi 1 pika b, si dhe neni 177 i Kodit Penal.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi.

PZAP, me datën 19.06.2012, ka ftuar në cilësinë e dëshmitarit vëzhguesit e subjektit politik LVV, Vedat Mexhuani dhe Zgjim Hysenin, në marrjen e deklaratave të tyre, rreth pretendimeve të ankimore në ankesën Anr.198/2012.

Dëshmitari Vedat Mexhuani në cilësinë e vëzhguesit të LVV-së në deklaratën e tij ka thekson se ka qenë vëzhgues në fshatin Kovaçec, dhe ka kërkuar të bëjë ndërrim për shkak të lodhjes, ku edhe ka ardhur Zgjim Hyseni për të bërë ndërrimin, gjatë njoftimit se si ka shkuar procesi, thotë se ka ardhur Bekim Troni me pesë persona të tjerë, të cilët e kanë nxjerrë Zgjim Hysenin dhunshëm nga vendvotimi, si dhe i kanë

kërcënuar të dytë, dhe e kanë detyruar që të kthehet prapë si vëzhgues. Deklaruesi me tutje thotë se edhe pse Zgjim Hyseni ka pasur bexh dhe ju ka treguar ata prapë kanë vepruar njëjt. Sa i përket Bekim Tronit, deklaruesi në deklaratën e tij thotë se ka bërë presion tek votuesit, dhe tek vëzhguesit gjatë tërë ditës, së bashku me pesë persona tjerë, si dhe pasi është kthyer nga tualeti, thotë se e kanë ndalur tre persona qe nuk i ka njohur dhe të cilët e kanë kërcënuar në prani të policit, thekson Vedat Mexhuani në deklaratën e tij.

Ndërsa dëshmitari Zgjim Hyseni në cilësinë e vëzhguesit nga LVV, në deklaratën e tij dhënë me 19.06.2012, thekson se ka shkuar në QV në fshatin Kovaçec për ta zëvendësuar vëzhguesin Vedat Mexhuanin, e të cilin e ka thirrur në korridor dhe ka biseduar rreth mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, ku pas një minute kanë dalur nga një klasë rreth 7-8 persona të cilët kanë kërkuar që të dalë jashtë, edhe pse ju kam treguar bexhin e vëzhguesit, dhe ju kam përsëritur disa herë që kam të drejtë të qëndroj në QV. Sipas deklaruesit personat në fjalë e kanë sharë, e kanë kërcënuar dhe e kanë shtyr për të dalë jashtë. Pasi më kanë nxjerrë nga shkolla deklaruesi thekson se kam lajmëruar policinë, pastaj kam hipur në veturë, ku njëri nga anëtarët tanë e ka njohur Bekim Tronin i cili kur ka dalë jashtë nuk ka pasur bexh por dikush nga mbrapa kishte ardhur dhe ja ka vendosur bexhin në qafë, thotë Zgjim Hyseni në deklaratën e tij.

PZAP, me datë 18.06.2012, ka bërë kërkesë për sigurimin e materialit të Librit të Vërejtjeve të VV 0719D, në QNR-KQZ. Më datë 19.06.2012, QNR-KQZ i është përgjigjur kërkesës së PZAP-it, duke i dërguar edhe kopjen e Librit të Vërejtjeve në Vendvotimin Nr.0719D, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Kaçanikut. Në kopjen e Librit të Vërejtjeve në këtë vendvotim shihet se votimi në fshatin Kovaçec, ka filluar sipas kohës, dhe është zhvilluar në mënyrë të qetë dhe të rregullt, do thotë çdo gjë ka shkuar në mënyrë të rregullt.

PZAP, me datë 19.06.2012, përmes postes elektronike ka bërë kërkesë stacionit policor në Kaçanik, për raportin policor lidhur me verifikimin e pretendimeve për ankesën Anr.198/2009, po ashtu në të njëjtën datë PZAP, ka pranuar nga stacioni policor përmes postes elektronike, raportin policor, në të cilin raportohet se me datën 17.06.2012, zyrtarët policor kanë qëndruar në QV 0719D, në fshatin Kovaçec, ku edhe gjatë gjithë kohës sa kanë qëndruar, kanë kontaktuar me menaxheren e kësaj QV, dhe asnjëherë nuk ka njoftuar për ndonjë parregullsi, e po ashtu edhe nga ana e vëzhgueseve dhe qytetarëve nuk ka pasur ndonjë ankesë, thuhet në raportin policor.

PZAP, me datën 20.06.2012, nëpërmjet telefonit ka bërë audio incizimin e deklaratës së dhënë nga Menaxherja QV 0719D, Florije Zeneli në fshatin Kovaçec, e cila deklaroi se nga pretendimet ankimore se është bërë presion, nuk janë të vërteta, dhe se vëzhguesi i subjektit politik i LVV, Vedat Mexhuani që nga orët e mëngjesit ka shkaktuar problem në QV, dhe se problemi ka qenë se ai i ka marrë kompetencat e tona, ndërsa rasti se Bekim Troni ka bërë trysni tek votuesit, një gjë e tillë nuk është e vërtetë, dhe përveç subjektit politik LVV, asnjë staf politik, komisioner, KKZ, KQZ e as ndonjë subjekt tjetër politik nuk kanë bërë vërejtje, përveç LVV. Menaxherja e QV, deklaroi se këto janë vetëm dezinformata dhe asgjë tjetër. Sa i përket ndërrimit të vëzhgueseve, në deklaratë theksohet se është fakt se janë nxjerr jashtë, arsyeja është

se kanë pasur vëzhgues, nuk kanë drejtë të jenë 2 ose 3 vëzhgues, ata kanë qenë të përcaktuar në këtë QV dhe jo të ndërrohen njëri me tjetrin.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase parashtruesi ankesës, nuk i është bashkangjitur asnjë provë ankesës që do të vërtetonte se ka ndodhur shkelja e supozuar në ankesë. Këtë e bënë edhe më bindëse raporti i policisë së Republikës së Kosovës i dhënë për QV 0719D, më datë 17.06.2012 në të cilin theksohet se nuk ka pas asnjë ankesë nga menaxherja e QV-së QV 0719D as nga vëzhguesit e as nga qytetarët.

Andaj PZAP, duke u bazuar në Librin e Vërejtjeve të siguruar nga QNR-KQZ, në deklaratën e dhënë nga Menaxherja e Vendvotimit si dhe nga shkresat tjera të lëndës vërtetoi se pretendimet ankimore në ankesë, nuk qëndrojnë për faktin, se pretendimet e tilla nuk janë të bazuara. Prandaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazë, dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 198/2012 më datën 21.06.2012.

Kryesuesi i Panelit  
**Ymer Hoxha**

